



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 145

Tiranë – E mërkurë, 3 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Kuvendit nr. 48/2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, të ndryshuar.....	11413
Vendim i Kuvendit nr. 49/2016	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive.....	11414
Vendim i Kuvendit nr. 50/2016	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive.....	11414
Vendim i Kuvendit nr. 51/2016	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive.....	11414
Vendim i Kuvendit nr. 52/2016	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive.....	11415
Vendim i Kuvendit nr. 53/2016	Për zgjedhjen e zotit Arben Malaj anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....	11415
Vendim i Kuvendit nr. 55/2016	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 96/2014, “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, të ndryshuar.....	11415
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 537, datë 27.7.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	11415
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 27.7.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 919, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr.102/2014, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë””	11416

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 543, datë 27.7.2016	Për lejimin e përdorimit të brigjeve në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “ <i>New Born</i> ”.....	11417
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 544, datë 27.7.2016	Për lejimin e përdorimit të brigjeve në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “ <i>Green Coast</i> ”.....	11417
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 27.7.2016	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për ndërtimin e Stacionit të Transferimit të Mbetjeve të Bashkisë Pogradec.....	11418
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 5419, datë 2.8.2016	Për delegim kompetence.....	11419
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 5420, datë 2.8.2016	Për delegim kompetence.....	11419



**VENDIM
Nr. 48/2016**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
55/2014, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE
KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE
TË PUNËS TË INSPEKTORATIT TË
LARTË TË DEKLARIMIT E
KONTROLLIT TË PASURIVE DHE
KONFLIKTIT TË INTERESAVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 60/2016,

“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 2 (organika) e vendimit të Kuvendit nr. 55/2014, të ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare në datën 1 shtator 2016.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 22.7.2016

Lidhja nr. 2

ORGANIKA DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

(Struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës janë miraturar sipas vendimit të Kuvendit nr. 55/2014 , të ndryshuar me vendimet e Kuvendit nr. 71/2015 dhe 108/2015)

Funksioni	Nr. i punonjësve /	Kategoria/klasa
I. Inspektori i përgjithshëm	1	<i>Ligj nr. 9584, datë 17.7.2006</i>
II. Kabineti		
Drejtor kabineti	1	II-a
Këshilltar	1	II-b
Sekretar i inspektorit të përgjithshëm	1	VKM
III. Sekretari i Përgjithshëm		
IV. Inspektorë		
Inspektorë	28	II-a
Ndihmësinsektorë	12	II-b
V. Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënive me Institucionet		
Drejtor	1	II-b
V/1. Sektori i Marrëdhënive me Autoritetet Përgjegjëse		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	3	III-b
V/2. Sektori i Këshillimit Juridik		
Specialistë	2	III-b
VI. Drejtoria e Financës dhe Administrimit		
Drejtor	1	II-b
VI/1. Sektori i Administrimit të IT-së		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist	2	III-b
VI/2. Sektori i Protokoll-Arkivit dhe Admi-nistrimit të Deklaratave të Pasurisë		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	5	III-b



VI/3. Sektori i Administrimit të Financë-Buxhetit

Specialist finance	1	IV-a
Specialist buxheti	1	III-b
Magaznier	1	VI
Shofer	2	IV
Receptionist	1	III
Pastruese	2	I
Gjithsej	70 punonjës	

VENDIM
Nr. 49/2016

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Zylyftar Bregu zgjidhet anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 22.7.2016

VENDIM
Nr. 50/2016

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Sami Nezaj zgjidhet anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 22.7.2016

VENDIM
Nr. 51/2016

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Suela Musta zgjidhet anëtare e Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 22.7.2016



**VENDIM
Nr. 52/2016**

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- I. Zoti Agron Gjekmarkaj zgjidhet anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 22.7.2016

**VENDIM
Nr. 53/2016**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ARBEN
MALAJ ANËTAR I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 44, pikat 2 dhe 3, dhe nenit 48, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- I. Zoti Arben Malaj zgjidhet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me mandat zëvendësues, në vend të zonjës Ermelinda Meksi.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 22.7.2016

**VENDIM
Nr. 55/2016**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 96/2014 “PËR KRIJIMIN
E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR REFORMËN NË
SISTEMIN E DREJTËSISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 24, të Rregullores së Kuvendit dhe pikës V, të vendimit të Kuvendit nr. 96/2014, me kërkesën e Kryetarit të Komisionit të Posaçëm për Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 96/2014, “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Në pikën V, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“V. Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë veprimtarinë e tij deri në fund të muajit dhjetor 2016”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 22.7.2016

**VENDIM
Nr. 537, datë 27.7.2016**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, çregjistrohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas ndryshimit bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA.

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”.

ASCHRAF 2. AL-DAGMA.

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 542, datë 27.7.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.919, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË LIGJIT NR.102/2014, DATË 31.7.2014, “KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË””¹²

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 10, 40 deri 42, 47, 119, pika 7, 149, 150 deri 152, 153, pikat 1, 2 e 3, 154, 161 deri 168, 169, 174, 175, 176, 177, 184 e 188, të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun 2, “Përjashtimi nga detyrimet e importit”, seksioni 5, “Dërgesat me vlerë të papërfillshme”, të vendimit nr.919, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, neni 116, “Mallra me vlerë të papërfillshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 116

Mallra me vlerë të papërfillshme

1. Në përputhje me nenin 117, çdo dërgesë mallrash me karakter jotregtar, e përbërë nga mallra me vlerë të papërfillshme, të dërguara drejtpërdrejt nga një vend tjetër te një marrës në Republikën e Shqipërisë, përjashtohet nga detyrimet e importit.

2. Për qëllime të pikës 1, mallra me vlerë të papërfillshme janë:

a) mallrat e blera nëpërmjet porosisë nga

¹ Direktiva 2006/79/EC, e datës 5 tetor 2006, “Mbi përjashtimin nga taksat e importit të dërgesave të vogla të mallrave me natyrë jotregtare nga vendet jashtë BE-së”. Celex nr.32006L0079; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.286, 17 October 2006, faqe 15–18;

² Direktiva 2009/132/EC, e datës 19 tetor 2009, “Mbi përcaktimin e qëllimit të nenit 143 (b) dhe (c) të direktivës 2006/112/ EC, në lidhje me përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin final të mallrave të caktuara”. Celex nr.32009L0132; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, 292, 10 nëntor 2009, faqe 5–30.



interneti, që importohen nëpërmjet dërgesave postare, vlera e të cilave nuk kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 22 euro;

b) dërgesat e mallrave nga një individ jashtë Republikës së Shqipërisë për një individ në Republikën e Shqipërisë, të një natyre rastësore, pa pagesë dhe që përmbajnë vetëm mallrat e destinuara për përdorim personal ose familjar prej marrësit, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 45 euro.”.

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr.543, datë 27.7.2016

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË
BRIGJEVE NË FUNKSION TË
REALIZIMIT TË PROJEKTIT
INVESTUES STRATEGJIK “NEW BORN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “New Born”, Hamallaj, gjiri i Lalëzit, i cili ka përfituar statusin e investimit strategjik, procedurë e asistuar, me vendimin nr.1/15, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

2. Afati për përdorimin e brigjeve, sipas këtij vendimi, të jetë 20 (njëzet) vite duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Përdorimi i brigjeve do të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror 15 maj – 30 shtator të çdo viti, përkundrejt pagesës së tarifës 100 lekë/m² në muaj nga ana e investitorit strategjik, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.

4. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve

administrohen dhe bëjnë pjesë në buxhetin e Bashkisë Durrës.

5. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik “Mane TCP”, me NIPT/NUIS K22203004A, koordinatat, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në përcaktimet e bëra në vendimin nr. 1/15, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike, dhe në përcaktimet e kontratës përkatëse që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Durrës.

6. Ngarkohet Bashkia Durrës për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik në zbatim të këtij vendimi. Në këtë kontratë parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimit e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimit e investitorit, në funksion të projektit të investimit strategjik.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 544, datë 27.7.2016

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË
BRIGJEVE NË FUNKSION TË
REALIZIMIT TË PROJEKTIT
INVESTUES STRATEGJIK “GREEN
COAST”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Green Coast”, Palasë, Himarë, zona kadastrale 1481–1739, i cili ka përfituar statusin e investimit strategjik, procedurë e veçantë, me vendimin nr.2/13, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike.



2. Afati për përdorimin e brigjeve sipas këtij vendimi të jetë 20 (njëzet) vite duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Përdorimi i brigjeve do të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror 15 maj – 30 shtator të çdo viti, përkundrejt pagesës së tarifës 100 lekë/m² në muaj nga ana e investitorit strategjik, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.

4. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve administrohen dhe bëjnë pjesë në buxhetin e Bashkisë Himarë.

5. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik “Green Coast”, me NIPT/NUIS: L41329038D, koordinatat, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në përcaktimet e bëra në vendimin nr.2/13, datë 14.7.2016, të Komitetit të Investimeve Strategjike, dhe në përcaktimet e kontratës përkatëse që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Himarë.

6. Ngarkohet Bashkia Himarë për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik në zbatim të këtij vendimi. Në këtë kontratë parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimit e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimit e investitorit, në funksion të projektit të investimit strategjik.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 546, datë 27.7.2016

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL, PËR NDËRTIMIN E STACIONIT TË TRANSFERIMIT TË MBETJEVE TË BASHKISË POGRADEC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, të sipërfaqes prej 5 900 (pesë mijë e nëntëqind) m², me vendndodhje sipas të dhënave në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e Stacionit të Transferimit të Mbetjeve të Bashkisë Pogradec.

2. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Qarkun e Korçës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore (arë) në tokë truall, për sipërfaqen prej 5 900 (pesë mijë e nëntëqind) m², sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Qarkut Korçë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

TOKË BUJQËSORE (KATEGORIA VIII)

Bashkia	Njësia administrative	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Kategoria e tokës bujqësore	Truall i kërkuar (m ²)
Pogradec	Çërravë	Çërravë	1387	77	tokë shtet	arë	VIII-të	5900

**URDHËR****Nr. 5419, datë 2.8.2016****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 11, pikës 2 dhe 3, të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 3.8.2016, deri në datën 8.8.2016, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Eridian Salianji.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Eridian Salianji, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

URDHËR**Nr. 5420, datë 2.8.2016****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 11, pikës 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, nga data 9.8.2016 deri në datën 26.8.2016, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Arben Isaraj.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë